



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
FAKULTETI I ARTIT SKENIK  
DEKANI

Nr. 66 prot.

Tiranë, më 01/03/2024

Lënda : Dërgohet rihapja për herë të dytë e thirrjes për aplikim për regjistrim në programin e ciklit të tretë “Doktoratë në Arte Skenike” për vitin akademik 2023 – 2024.

Rektorit të Universitetit të Arteve  
Prof. Kastriot ÇAUSHI

Zoti Rektor,

Bazuar në Urdhrin e Ministrit të Arsimit nr. 127, datë 16.03.2022, "Për hapjen e Programit të Studimit të ciklit të tretë, Doktoratë në "Arte Skenike" në Universitetin e Arteve të Tiranës" dhe në kuadër të hapave të marra në plotësim të detyrimeve të dala nga ky urdhër nga ana e Departamenti Regji dhe Regji Filmi & TV, po Ju dërgoj “Rihapjen për herë të dytë të thirrjes për aplikim për regjistrim në programin e ciklit të tretë “Doktoratë në Arte Skenike” në programet e studimit FAS pranë Njesisë Bazë Regji dhe Regji Filmi & Televizioni, në Universitetin e Arteve për vitin akademik 2023 – 2024”.

Ju faleminderit !

DEKANI

Prof. Ilir MARTINI



FAKULTETI I ARTIT SKENIK



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
FAKULTETI I ARTIT SKENIK  
NJËSIA BAZË REGJI DHE REGJI FILMI & TELEVIZIONI

Tiranë, më 01/03/2024

**Lënda:** Rihapje për herë të dytë e thirrjes për regjistrim në programin e ciklit të tretë “Doktoratë në Arte Skenike” në programet e studimit FAS pranë Njesisë Bazë Regji dhe Regji Filmi & Televizioni, në Universitetin e Arteve për vitin akademik 2023 – 2024”.

### THIRRJE PËR APLIKIM

I nderuar zoti Dekan,

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë", Neni 78, pika 2, Neni 79, pika 4 dhe 6; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.112, datë 23/2/2018, "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor", Kreu I; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.808, datë 11.12.2019 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 112, datë 23/2/2018, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i asociuar" dhe "Profesor"; Urdhrin e Ministrit të Arsimit nr. 127, date 16/03/2022, "Për hapjen e Programit të Studimit të ciklit të tretë, Doktoratë në "Arte Skenike" në Universitetin e Arteve të Tiranës”, në nenin 3, pika 1, të rregullores "Për Programin e Studimeve të Ciklit të III për fitimin e Gradës Shkencor "Doktor" në Arte Skenike në programet e Studimit FAS pranë Njesisë Bazë Regji dhe Regji Filmi dhe Televizioni, në Universitetin e Arteve" miratuar me VSA nr. 33 dt. 17/11/2021 Mbi “Miratimin e Rregullores të Ciklit të III të Studimeve për fitimin e gradës shkencore Doktor në Arte Skenike, në Programet e Studimit të FAS pranë Njesisë Bazë Regji dhe Regji Filmi dhe Televizioni në Universitetin e Arteve”, shkresën e MAS Nr. 1870/3 Prot., dt. 24/04/2023, "Mbi listën e udhëheqësve shkencorë në programet e studimit të ciklit të tretë "Doktoratë" Për vitet akademike 2022-2023 dhe 2023-2024" si dhe Udhëzimin nr. 10 MAS dt. 16/6/2023 “Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 52 dt. 3/12/2015, “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë, i ndryshuar”:

**Departamenti Regji dhe Regji Filmi & Televizioni, pas shpalljes së rezultateve për fituesit e konkursit për Ciklin e III-të “Doktoratë në Arte Skenike” (Vendimi 01, dt. 24/01/2024 i Dekanit të FAS “Për shpalljen e vlerësimeve të Komisionit të Pranimit të**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

kandidatëve konkurrues në studimet e doktoratës për vitin akademik 2023-2024 në Fakultetin e Artit Skenik”), pas dorëheqjes nga këto studime doktorale të njërit prej fituesve të shpallur, si dhe në mungesë të regjistrimeve të tjera në rihapjen e thirrjes më dt. 05/02/2024, vendosi:

Të shpallë rihapjen për herë të dytë të thirrjes për aplikim duke parashtruar këtu kuotat e pranimit, kohëzgjatjen, strukturimin, kriteret e pranimit, afatet e konkurrimit, përmbajtjen e dosjes konkurruese si dhe tarifat për Ciklin e Tretë “Doktoratë në Arte Skenike” për vitin 2023-2024 në Fakultetin e Artit Skenik si me poshtë:

**I. Kuotat e lira për pranimin në Ciklin e Tretë “Doktoratë në Arte Skenike” për vitin 2023-2024 do të jenë 2 (dy) për nënfushat si vijon:**

Akrim; Regji; Skenografi-Kostumografi; Koreografi; Regji Filmi dhe Televizioni.

**II. Kohëzgjatja e studimeve të Doktoraturës:**

Studimet e doktoraturës zhvillohen me kohë të plotë, pranë Njesisë Bazë të RRFTV, në bashkërendim me Njësitë Bazë në FAS dhe kanë një kohëzgjatje normale jo më pak se 3 (tre) vite akademike dhe jo më shumë se 5 (pesë) vite akademike.

Në rastet kur kandidati për doktorant është i punësuar si personel akademik, me kohë të plotë ose të pjesshme, pranë një tjetër institucioni të arsimit të lartë, apo si personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar, pranë institucioneve të arsimit të lartë të llojit Universitet ose Akademi, studimet mund të zhvillohen me kohë të zgjatur (5 vite akademike).

**III. Strukturimi i shkollës doktorale:**

Veprimtaritë e kryera në kuadër të doktoraturës	Viti I	Viti II	Viti III
Pjesëmarrje në Forumin e Doktoratës	Mbajtja e një referati në Forumin e Doktoratës	Mbajtja e një referati në Forumin e Doktoratës	Mbajtja e një referati në Forumin e Doktoratës
Paraqitje përpara Komisionit të Vlerësimeve të Pjesshme	Prezantim i Detajuar i projektit kërkimor	Prezantimi i punës kërkimore dhe rezultateve të arritura	Paraqitja e fundit e punës kërkimore
1) Realizimi i të paktën tre referimeve në veprimtari shkencore (simpoziume, konferenca, kongrese). 2) Botimi i të paktën tre artikujve shkencorë në revista shkencore.			



**IV. Aplikimet në programin e studimeve të Doktoratës do të pranohen nga kandidatët që plotësojnë kriteret si më poshtë vijon:**

- Të zotërojnë një diplomë Bachelor dhe Master Shkencor/Master i Arteve, ose Diplomë të sistemit të vjetër 4 vjeçar/studime analoge jashtë vendit, në fushën ku ofrohet programi i studimit ose në fusha të ngjashme. Në rastin kur Diplomat e fituara (cikli i parë dhe cikli i dytë) janë dhënë nga një IAL jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duhet të jenë ekuivalentuar nga MAS konform ligjeve në fuqi. Për tu pranuar në programin e Doktoratës kandidatët kanë detyrimin që të zotërojnë diplomë të ciklit të parë dhe diplomë të ciklit të dytë, sipas përcaktimeve të këtij paragrafi, në fusha të ngjashme/të përafërta.
- Kandidatët që zotërojnë diplomë, sipas përcaktimeve më sipër, në fusha të përafërta, vlerësohen bazuar në përputhshmërinë e lëndëve dhe programeve të kurrikulës së tyre (Bachelor dhe Master) me ato të kurrikulës së programit të njëjtë (Bachelor dhe Master) që paraprin programin e studimeve të Doktoratës.
- Prioritet merr kandidati që ka angazhim akademik pranë FAS, si staf akademik me kohë të plotë ose si staf akademik i ftuar.
- Të dëshmojë njohuritë në një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht), e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Nëse individit ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.
- Në studimet e Doktoraturës do të pranohen vetëm kandidatët të cilët, në studimet Master i Arteve ose Master i Shkencave (ose në diplomën e sistemit 4 vjeçar) mesataren e ponderuar e kanë më të lartë ose të barabartë me 8.
- Kandidati duhet të plotësojë dhe të paraqesë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për t'u pranuar në konkurrim sipas Shtojcës 1 të Rregullores "Për Programin e Studimeve të Ciklit të III për fitimin e Gradës Shkencor "Doktor" në Arte Skenike në programet e Studimit FAS pranë Njësisë Bazë Regji dhe Regji Filmi dhe Televizioni, në Universitetin e Arteve".
- Të drejtën për t'u regjistruar në Konkursin e pranimit për studimet e doktoratës e kanë edhe kandidatët me kombësi shqiptare që jetojnë jashtë kufirit të RSH sikurse dhe shtetasit e tjerë të huaj që plotësojnë kushtet e mësipërme (këta të fundit duhet të dëshmojnë, me dokumentacionin përkatës, njohjen e gjuhës shqipe konform ligjeve në fuqi).



**V. Kriteria specifike që duhen mbajtur parasysh gjatë konkurrimit për nënfusha specifike:**

**Në qoftë se do të aplikohet në Ciklin e Tretë “Doktoratë në Arte Skenike” nënfusha “Aktrim”, duhet të mbahen parasysh edhe këto kriteria specifike:**

Të zotërojë një diplomë Bachelor dhe Master Shkencor/Master i Arteve, ose Diplomë të sistemit të vjetër 4 vjeçar/studime analoge jashtë vendit, në fushën e Aktrimit ose në fusha të ngjashme. Në rastin kur Diplomat e fituara (cikli i parë dhe cikli i dytë) janë dhënë nga një IAL jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duhet të jenë ekuivalentuar nga MAS konform ligjeve në fuqi.

**Në qoftë se do të aplikohet në Ciklin e Tretë “Doktoratë në Arte Skenike” nënfusha “Regji”, duhet të mbahen parasysh edhe këto kriteria specifike:**

Të zotërojë një diplomë Bachelor dhe Master Shkencor/Master i Arteve, ose Diplomë të sistemit të vjetër 4 vjeçar/studime analoge jashtë vendit, në fushën e “Regjisë” ose në fusha të ngjashme. Në rastin kur Diplomat e fituara (cikli i parë dhe cikli i dytë) janë dhënë nga një IAL jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duhet të jenë ekuivalentuar nga MAS konform ligjeve në fuqi.

**Në qoftë se do të aplikohet në Ciklin e Tretë “Doktoratë në Arte Skenike” nënfusha “Skenografi-Kostumografi”, duhet të mbahen parasysh edhe këto kriteria specifike:**

Të zotërojë një diplomë Bachelor dhe Master Shkencor/Master i Arteve, ose Diplomë të sistemit të vjetër 4 vjeçar/studime analoge jashtë vendit, në fushën e "Skenografi-Kostumografisë" ose në fusha të ngjashme. Në rastin kur Diplomat e fituara (cikli i parë dhe cikli i dytë) janë dhënë nga një IAL jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duhet të jenë ekuivalentuar nga MAS konform ligjeve në fuqi.

**Në qoftë se do të aplikohet në Ciklin e Tretë “Doktoratë në Arte Skenike” nënfusha “Koreografi”, duhet të mbahen parasysh edhe këto kriteria specifike:**

Të zotërojë një diplomë Bachelor dhe Master Shkencor/Master i Arteve, ose Diplomë të sistemit të vjetër 4 vjeçar/studime analoge jashtë vendit, në fushën e "Koreografisë" ose në fusha të ngjashme. Në rastin kur Diplomat e fituara (cikli i parë dhe cikli i dytë) janë dhënë nga një IAL jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duhet të jenë ekuivalentuar nga MAS konform ligjeve në fuqi.

**Në qoftë se do të aplikohet në Ciklin e Tretë “Doktoratë në Arte Skenike” nënfusha “Regji Filmi & Televizioni”, duhet të mbahen parasysh edhe këto kriteria specifike:**

Të zotërojë një diplomë Bachelor dhe Master Shkencor/Master i Arteve, ose Diplomë të sistemit të vjetër 4 vjeçar/studime analoge jashtë vendit, në fushën e "Regjisë së Filmit & Televizionit" ose në fusha të ngjashme. Në rastin kur Diplomat e fituara (cikli i parë dhe



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

cikli i dytë) janë dhënë nga një IAL jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duhet të jenë ekuivalentuar nga MAS konform ligjeve në fuqi.

**VI. Afatet për konkurrim:**

Kalendari i ri i pranimit të aplikimeve për Ciklin e Tretë “Doktoratë në Arte Skenike” për vitin 2023-2024 në Fakultetin e Artit Skenik do të jetë në datat **04 Mars 2024 – 11 Mars 2024**. Konkurrimi bëhet me dosje. Kandidati dosjen për konkursin e ciklit të tretë të studimeve e dorëzon në Sekretarinë Mësimore të FAS. **Afati i fundit i pranimeve është ora 16.00 e datës 11 Mars 2024.**

**VII. Përmbajtja e dosjes konkurruese të kandidatëve:**

Dokumentacioni i nevojshëm për t'u Regjistruar në Konkursin e pranimit Ciklin e Tretë “Doktoratë në Arte Skenike”, sipas përcaktimeve të Shtojcës 1 të “Rregullores së Programit Të Studimeve Të Ciklit III Për Fitimin E Gradës Shkencore “Doktor” Në Arte Skenike Në Programet E Studimit Të FAS Pranë Njësisë Bazë Regji Dhe Regji Filmi & Televizioni Në Fakultetin E Artit Skenik”:

1. Kërkesë me shkrim nga ana e kandidatit për nënfushën ku do të studiojë.
2. Certifikata e lindjes (origjinal)
3. Certifikata e martesës apo dokument tjetër i ndryshimit të mbiemrit (kopje e noterizuar).
4. Kopje e noterizuar e Supplementit të Diplomës Bachelor ose studimeve 4 vjeçare ose studimeve analoge jashtë RSH. Në rastin e fundit dokumenti është njohur si i barasvlefshëm në MAS.
5. Kopje e noterizuar Listës së notave dhe Krediteve në Studimet Bachelor ose studimeve 4 vjeçare ose studimeve analoge jashtë RSH. Në rastin e fundit dokumenti është njohur si i barasvlefshëm në MAS.
6. Kopje e noterizuar e Supplementit të Diplomës Bachelor ose studimeve 4 vjeçare ose studimeve analoge jashtë RSH. Në rastin e fundit dokumenti është njohur si i barasvlefshëm në MAS.
7. Kopje e noterizuar të Diplomës Master ose studimeve 4 vjeçare ose studimeve analoge jashtë RSH. Në rastin e fundit dokumenti është njohur si i barasvlefshëm në MAS.
8. Kopje e noterizuar të Listës së notave dhe Krediteve të Diplomës Master ose studimeve 4 vjeçare ose studimeve analoge jashtë RSH. Në rastin e fundit dokumenti është njohur si i barasvlefshëm në MAS.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

9. Kopje e noterizuar e Supplementit të Diplomës Master ose studimeve 4 vjeçare ose studimeve analoge jashtë RSH. Në rastin e fundit dokumenti është njohur si i barasvlefshëm në MAS.
10. Kopje të noterizuara të studimeve Pas-Master, programeve të ndryshme të formimit të vazhduar etj. të kryera brenda dhe jashtë RSH. Në rastin e fundit dokumenti/at është/janë njohur si i/të barasvlefshëm në MAS.
11. Kopje e pasaportës (për qytetarët e huaj)
12. CV-ja e veprimtarisë shkencore/artistike
13. Dosjen me dokumente që vërtetojnë CV-në e kandidatit.
14. Kopje e noterizuar e Dëshmisë së Gjuhës së huaj sipas kërkesave standard të MAS.
15. Synopsis i Temës së propozuar të Disertacionit dhe programin për të cilin konkurren.
16. Bibliografia që do të përdoret për Temën e propozuar
17. Propozimi për Udhëheqësin e Temës së Disertacionit
18. Miratimi i Udhëheqësit të propozuar të Disertacionit
19. Formulari i Regjistrimit
20. Mandat pagesa e Regjistrimit (5,000 (pesëmijë) lekë)
21. Deklaratë që Kandidati nuk ka qenë më përpara pjesë e një programi studimor në doktoraturë në të cilën është vlerësuar negativisht.
22. Dy rekomandime nga pedagogë të kategorisë që kanë së paku gradën “Doktor” ose i përkasin kategorisë “Profesor”

**VIII. Vlerësimi i kandidatëve:**

Njësia Bazë e RRFTV, në bashkërendim me Njësitë Bazë në FAS ngre Komisionin e Pranimit i cili vlerëson me pikë elementët e dosjes së kandidatit. Dosja e kandidatit i dorëzohet Komisionit të pranimit nga Sekretaria mësimore e FAS.

Vlerësimi maksimal i kandidatit është me 100 pikë. Minimumi i pikëve të grumbulluara për tu pranuar në programin e studimit të ciklit të tretë “Doktor” në Artet Skenike është 40 pikë.

**IX. Tarifa e studimit të programit të doktoratës “Doktoratë në Arte Skenike”:**

- Tarifa e studimit të programit “Doktoratë në Arte Skenike” është përcaktuar në masën 504,000 (pesëqindekatërmijë) Lekë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

- Tarifa e studimeve të doktoratës paguhet me këste si më poshtë vijon:
  - a. Kësti i parë i tarifës së studimeve të doktoratës (25% e shumës) paguhet në përfundim të semestrit I;
  - b. Kësti i dytë i tarifës së studimeve të doktoratës (25% e shumës) paguhet në përfundim të semestrit III nga nisja e studimeve të doktoratës;
  - c. Kësti i tretë dhe i fundit i tarifës së studimeve të doktoratës (50% e shumës), paguhet në përfundim të semestrit V, por në çdo rast më parë se paraqitja e kërkesës për Mbrojtjen e Temës së Doktoratës.

**X. Trupa e lirë pedagogjike e studimeve të doktoratës në Fakultetin e Artit Skenik:**

Personeli akademik	Titulli / grada	Nr. i udhëheqjeve
1. Elida RAPTI	Prof. as. dr.	1
2. Rozina PRENDI	Prof. as. dr.	1

Mbyllet me nr. Rendor 2 (dy).

**PËRGJEGJËSI I NJËSISË BAZË**

**Prof. as. Alert ÇELOALIAJ**